

LIGJ
Nr.9250, datë 1.7.2004

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 "PËR SANKSIONIMIN DHE
MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE TË
PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimit", i ndryshuar, pas paragrafit të parë të pikës 1 të nenit 22 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përfshimisht, miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private për pasuritë e luajtshme kryhet nga organi që i administron ato.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4287, datë 29.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**